9, SQUARE LAMARTINE
PARIS XVII

Shum i dashtun memedhétar

Mé rastjén é konstitucionit (kanun-i-esasi) sido kudo u ndryshuane punerat ne Turqi; u dha gni fare lirié mé ane te se cilese Shqypetanete nuk kéna mé pas ata frike qe kishin pas mă pare; tani lirnar mundin mé thene qe jane Shqipetare, te bejne gith faresh shoqenira per mé lulezu gjuhen é vet é.t.t. Po te githa keto nuk kéna mé ja mbush synin Shqyptanit vertéte Shqyptanin é vertéte vétem gni vét-urdhenim i Shqypnise lupsét mé kenaq; ç'do tjatre gă asht gepure, asht gni gă é pakekoheshmé dhé me ne funt gni gă é cila mund mé shty-me gni robeni te pafuntmé. Ç'do komp i cili ron ne Sinisi te Ballkanit ka dhe gni progres; Bullgari Bullgarine, Gréku Gréqine, Serbi Serbine, Vllahu Vllahine dhé me ne funt Turku Turqine. Po Shqyptani i mjére ke ka?!!! Kush mund mé diftu progres i keti?... Kush do te doje xqimin é perparimin é ti?... Cili kéna mé dash mé pa Shqypetanin te fuqishim! Bullgari qi é numeron Dibrin te tine! Gréku qi kerkon Greqine tá madhoje dyke shtuar Epirone! Serbi qe kerkon Serbin'é Vjétene a po Turku i cili dyké mé numeru Shqypnine gni pjés te Turqise, vété pas fjalene: „Turqia per Turqit"?!!! Faqeza po shikoni sé ç' do komp ka dhé gni qellim te keq per fatine te se dashtunes tone memedhé dhé per kete shkak kishte mé qene shume mundim per mă tregu progres i saj. Pra, Shqyptanet mé qene gith mone te bashkumun dhé mé rojt mé dashtuni pa perqnohure bese; d.m.th. Myslimane, Katholike a Orthodhokse lété mbajne si gjid kush besene qi ka, po ne pune kombesié duét mé lith gni bése dhé gni bashkim te kombiarte te cilat kéna

mé qen i vétemi shpetim kundre qellimévé liq te armiqvé, te cilet i kane rethuar. Shqypetaret qe te mundin mé largu nga ghithe rezikét qe i kane rethu, duét mbä se pari, si thame, mé dhen bese njeri jétrit dhé te lidhine shoqenina qellim i te cilavé te jéte:

1) Kombesia Shqypé é gnohure me nje per Myslimane, Katholike, Orthodhokse.

2) Skolla, Shtypeshkrogna, gazéta e.t.t. shqip.

3) Ushteria mos dale jashte kufivé te Shqypnise.

4) Kombesia Shqypé é gnohure sikur githe kombesite te Ballkanite.

5.) Mblédhjé mé pléq Shqypetare.

Ky asht programi qe duét mé pas ne menjé ç'do Shqyptar dhé mé kete te punoje. Ky asht i vétemi shpetim per Shqypetaret. Ay Shqyptar qi ka nde mendjé nji program te tille, ay asht i vertéte memedhétar. Ç'do punetor i kombit do te nimonét si kurdo hére, ne asht se kishte mé pas nevojé per nime.

Pra, dyké mé mavu létrene timé, te uroj qe gjithe keta qellimé te vertéte dhé te dobishmé per kombine tone te zéne vent ne zémere tendé, per mirési dhé perparim te memedhéut.

Te puth ne balle mé mall

„Perendia bashke mé né"

Ghini

Princ Kastrioti Skenderbeu

Fs/67

BIBLIOTEKA KOMB... TI...